

## Zhvillohen në KLSH sesionet e trajnimit me ekspertët norvegjezë për auditimet e performancës

Në datat 12-13 dhe 18-19 nëntor 2024, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvilluan sesionet e trajnimit të drejtuara nga ekspertët norvegjezë për auditimet e performancës. Këto sesione trajnimiti u zhvilluan në kuadër të programit të aktiviteteve të miratuara, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit dypalëshe.

Auditimi i parë është ai me temë “Cilësia e ujërave në plazhe” me grupin e përbërë nga z. Aulent Guri (përgjegjës i grupit), znj. Arminda Bushi, znj. Annavanessa Hoxhaj, znj. Vjola Kojani dhe znj. Eva Kushta dhe nën ekspertizën e ekspertëve norvegjezë znj. Guri Andrea Lowrie dhe z. Bjørn Martin Ørvim.

Auditimi i dytë i përzgjedhur është ai me temë “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor para-universitar” me grupin e përbërë nga z. Klarenc Xhaferaj (përgjegjës i grupit), znj. Xhuljeta Çelaj, znj. Jorida Zhegu, znj. Arjeta Çoku, dhe znj. Brisilda Hyka, nën ekspertizën e ekspertëve norvegjezë, znj. Florina Zagragja, z. Torkel Gram-Haga dhe z. Bjørn Harald Bratli.



Fokusi kryesor i asistencës së ekspertëve norvegjezë në të dy auditimet është mbështetja ndaj grupeve respektive të auditimit duke filluar nga hartimi i draft-programeve të auditimit, për të kaluar më tej në detaje lidhur me piramidën e pyetjeve me të gjitha nën-pyetjet e nivelit të dytë, si dhe çështjet apo gjetjet që priten të gjenerohen për secilën nën-pyetje deri tek proceset e hartimit, të paraqitjes vizuale të të dhënave, mbështetur në praktikat më të mira të SAI-t të Norvegjisë.



Grupet e auditimit prezantuan të dhënat e siguruara deri më tani, subjektet nga të cilat janë gjeneruar këto të dhëna, si dhe pritshmëritë mbi gjetjet e mundshme të auditimit.

Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi, i falënderoi përfaqësuesit e SAI-t të Norvegjisë për të gjithë

angazhimi e tyre dhe theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi, në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të proceseve të auditimit të performancës në KLSH. Nga ana e tyre gjithashtu, ekspertët norvegjezë shprehën gatishmërinë për të vijuar mbështetjen, referuar praktikave që ndiqen prej tyre në auditimet e performancës, si dhe intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis dy SAI-ve.

Diskutimi dhe shkëmbimi i informacioneve do të vijojë më tej edhe në platformën online, deri në përfundimin e projekt-raporteve të auditimit.